REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

# PROGRAMI I LËNDËS:
# LETËRSI FRËNGE E SHEK. XX

**Ngarkesa**: 6 kredite; 60 orë mësimore;
**Viti akademik:** viti III, semestri II
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme
**Programi i studimit:** Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe
**Kodi i Etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

## PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

*Objektivat e përgjithshme lëndore:*

Kjo lëndë psaqyron evoluimin e letërsisë franceze gjatë shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI, përmes veprave më të njohur dhe autorëve më përfaqësues që shenjuan këtë periudhë kohore. Lënda synon gjithashtu t'i iniciojë studentët në analizën e veprave letrare të zhanreve të ndryshme ( 10 orë mësimore për secilën gjini) dhe t'i pajisë ata me teknika dhe instrumente bazë për studimin e teksteve të ndryshme letrare në një perspektivë hermeneutike dhe nën një qasje krahasimore.

*Objektivat specifike lëndore:*
-kjo lëndë synon t'i iniciojë studentët njëkohësisht në analizën e veprave më të shquara letrare
- i pajis ata me teknikatë analizës së teksteve dhe intertekstualitetit
- i njeh me një qasje krahasimore që u lejon të kuptojnë evoluimin e letërsisë franceze përmes zhanreve të ndryshme.
Studentët aftësohen:

*Rezultate të pritshme:*
Studenti duhet të njohë se si të:
-identifikojë gjinitë letrare
-dallojë tiparet dhe karakteristikat e gjinive në fjalë
-të njohë tematikat e prekura nga të 4 gjinitë në shekullin e XX
-të realizojë komente dhe analiza mbi vepra të autorëve të studiuar